



## FSHATI RADAC

Fshati Radac është një ndër bukuritë atraktive të qytetit turistik të Pejës. Prejardhja e emrit të këtij fshati njihet nga një histori e vjetër kur banorët e Sanxhakut për t'li bluar drithërat në mullirin e Radacin kanë pyetur për njoftim: a është rruga e hapur për në këtë fshat? Ndërsa ata të tjerët janë përgjigjur: “po se ka ra Daci” (Daci është fshati më i afërt që gjindet në Malin e Zi). Ky fshat njihet si një nga zonat turistike të Pejës që ofron turizmin ambiental.

Pasuria e madhe me potencialet natyrore e veqon këtë fshat duke i dhënë emrin e zonës turistike ku gjatë vitit vizitohet nga turistë të shumtë vendor dhe të huaj. Thjeshtë është parajsja e pushimit ditor. Shtrihet në veri-lindje të Pejës, 11 km në largësi nga qendra e qytetit në rrugës magjistrale për Malin e Zi. Ekonomia kryesore e këtij fshati është bujqësia dhe turizmi.

Pasuritë natyrore të shumta si ujëvara e drinit, shpella e radacit, majet malore, flora dhe fauna, terrenet e përshtatshme për ecje malore dhe

ngjitje në shkëmbinjë, lëshim me paraglide, lidhje me zonën e Rugovës dhe bjeshkët e Rozhajës në Malin e Zi etj, e kanë radhitur këtë fshat në zonë me interes të veçantë turistik për Pejën. Shumë banorë të Pejës por edhe turistë të huaj tani e vizitojnë këtë fshat edhe me biçikleta ku edhe e kalojnë kohën nën freskinë e ujit dhe flladin e kanjonit të Drinit të Bardhë në gjatësi prej afër 400m.

Si specialitet i kësaj zone njihet peshku trofta. Një karakteristikë tjetër e veqon këtë fshat, përveq ajrit të pastër dhe ambientit malor është edhe klima e freskët që në ditët e ngrohta të verës mund të keni mundësinë të qëndroni nën freskun i cili vie nga kanioni i Drinit të Bardhë.



Kontakt:  
Komuna e Pejës  
Drejtorati për Zhvillim Ekonomik  
Sektori i Turizmit

web:  
e-mail:

[www.pejaturism.org](http://www.pejaturism.org)  
[pejaturism@yahoo.com](mailto:pejaturism@yahoo.com)

tel.

+381 39 423 949



# UJËVARA DRINI I BARDHË



# UJËVARA E DRINIT TË BARDHË

Bukuria natyrore dhe atraksioni turistik i komunës së Pejës padyshim është “Ujëvara e Drinit të Bardhë”. Ajo është nga ujëvarat më spektakolare të Kosovës e cila vizitohet nga turistët gjatë tërë vitit.

Burimi i Drinit të Bardhë është një nga burimet më të rëndësishme të Kosovës dhe një nga burimet që furnizon qytetin e Pejës me ujë të pijes. Vlenë të theksohet se me ujin e këtij burimi prodhohet edhe “Birra Peja” e njohur për kualitetin e lartë të saj. Buron rrëzë bjeshkës së Rusolisë, nga gurra e shpellës së Radacit në lartësi mbidetare prej 586m. Ka një kapacitet prunjesh të ujit prej 65m<sup>3</sup>/sec. Vlenë të theksohet se uji i këtij burimi shquhet për nga cilësia e kategorisë së parë dhe në vete përmban 7% jod ndërsa temperature e tij gjatë tërë vitit nuk bie nën 8gradë Celsius. Burimi njëherit krijon edhe ujëvaren e bukur të Drinit në gjatësi prej 30m.

Në territorin e Kosovës – Drini i bardhë gjarpëron për 122km në drejtim veri-jug. Ai mbledh në vete edhe ujërat e Lumbardhit të Pejës, Erenikut dhe lumbardhit të Prizrenit.

Me një madhësi prej 4646km<sup>2</sup>, bazeni i Drinit është më i madhi nga 4 bazenet ujëmbledhëse të Kosovës.

Qasja për në burim apo e “Ujëvara e Drinit të Bardhë” mund të bëhet nga dy anë: ku njëra anë të shpie nga rruga e hidrocentralit apo restaurant “Ujëvara e Drinit” për të ndjekur pastaj shtegun e këmbësorëve përgjatë bukurisë së lumit Drini i Bardhë nën hijen e pemëve dhe freskut që qarkullon përmes kanjonit në gjatësi deri në 400m, si dhe qasja tjetër në drejtim të restaurantit “Trofta e Drinit” ku mund të afroheni me makinë deri te shtegu për të vazhduar ecjen deri te ujëvara.

## SHPELLA E RADACIT

Shpella e Radacit gjindet afër ujëvarës së Drinit të Bardhë. Shtrihet në pjesën verilindore të vargmaleve të Bjeshkëve të Nemuna. Shpella është e thelluar në shkrepë të cilët e përbëjnë majen e Rusolisë me lartësi mbidetare 2381m ndër të cilën shtrihet fusha e Drinit të Bardhë.

Me vetitë e veta morfologjike është e radhitur me disa degë dhe galeri, salla,

korridore dhe kanale. Si shpellë e lumit, me formimin dhe funksionimin, ajo dallohet me pjesët e thata dhe të lagështa të liqejeve dhe të galerive. Formimi i shpellës është i lidhur me evolucionin hidrologjik të pjesës perëndimore të krasit gëlqeror të majës së Rusolisë. Rrjedha nëntokësore ka formuar kanale më të mëdha të cilat janë ndërtuar në ohën e para Levantit, kanalet më të mëdha të shpellës janë krijuar në kohën e liqejeve më të ulët, kur edhe është formuar galleria e dytë e shpellës. Me shpërthimin e ujit të palëshuar të barrierës është mundësuar edhe më tej të bëhet lëshimi vertikal i burimit të Drinit të Bardhë. E pasuruar me dekorime prej çfarëdo shpelle në shkrepë e këtij territori, shpella e Radacit me lidhjet e shumta të kanaleve nëntokësore, galerive të lehta për ecje dhe kushteve dhe vetive mikroklimatike, paraqet një objekt mjaft tërheqës turistik.

